



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA SHKODËR

Nr. 7186 Prot

Shkodër, më 27.05.2020

VENDIM

Nr. 117, datë 27.05.2020

"Për miratimin e Planit të Detajuar Vendor të njësisë strukturore SH026.UB"

Në mbështetje të nenit 8, pika 2, nenit 9, pika 1/1 shkronja "b" dhe nenit 23, pika 14, të ligjit nr. 139/2015, datë 17.12.2015 "Për vetëqeverisjen vendore", nenit 5, pika 1.3, shkronja "b", nenit 13, pika 1, shkronja "dh", si dhe nenit 22, të ligjit nr.107/2014 datë 31.07.2014 "Për planifikimin dhe zhvillimin e territorit", i ndryshuar; nenit 72 të VKM nr. 686, datë 22.11.2017 "Për Miratimin e Rregullores së Planifikimit të Territorit", i ndryshuar; Planit të Përgjithshëm Vendor të Bashkisë Shkodër, miratuar me vendim Nr.5, datë 16.10.2017 nga Këshilli Kombëtar i Territorit, Nismës Nr. 183, datë 15.10.2019 për hartimin e PDV-së në Njësinë Strukturore SH026.UB, Akt-Përputhshmërisë datë 17.04.2020 të Agjencisë Kombëtare të Planifikimit të Territorit si dhe Raportit Teknik të Drejtorisë së Studimeve. Planifikimit dhe Koordinimit të Investimeve. Bashkia Shkodër "Mbi shqyrtimin për miratim të planit të detajuar vendor të njësisë strukturore SH026.UB",

VENDOSA:

1. Miratim e planit të detajuar vendor për njësinë strukturore me Kod SH026.UB e cila kufizohet ndërmjet rrugëve: « Bulevardi Zogu i Parë », rr. «Baja Vogël»,rr. «Bulevardi Mehmet Pashë Plaku», rr. «Daut Boriçi», rr. «Hafiz Sabri Bushati».
2. Ngarkohet Drejtoria e Studimeve, Planifikimit dhe Koordinimit të Investimeve për botimin e dokumentacionit përfundimtar të PDV-së me kod SH009.UB në Regjistrin Kombëtar të Planifikimit të Territorit sipas legjislacionit në fuqi.
3. Ngarkohet Drejtoria e Studimeve, Planifikimit dhe Koordinimit të Investimeve dhe Drejtoria e Kontrollit dhe Zhvillimit të Territorit për zbatimin e Planit të Detajuar Vendor.
4. Ky vendim hyn në fuqi me botimin në Regjistrin Kombëtar të Planifikimit të Territorit.

KRYETAR

Voltana Ademi

